



# Newsletter Bota e SIGAL UNIQA



Edhe pse kanë kaluar më shumë se 25 vjet nga themelimi, jemi të lumtur që 1.2 milionë klientë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut vazhdojnë t'i besojnë Grupit "SIGAL UNIQA" jetën, shëndetin, pronën, automjetin e çdo gjë tjetër me vlerë. Ky besim, gjithmonë e në rritje, na nxit akoma më shumë të sjellim në të trija shtetet ku operojmë produktet më të mira dhe novatore të sigurimeve, të shërbejmë profesionalisht dhe të paguajmë dëmet në kohë! Faleminderit!

**Më poshtë do t'ju njohim me zhvillimet kryesore brenda grupit për muajin Prill.**

# PËRMBAJTJA

“SIGAL UNIQA” zhvillon Konferencën Rajonale/ Ponari: Më të mirët! Shkojmë tek klienti me çdo produkt sigurimi

Mini-kampionati “SIGAL UNIQA”/ Kosova fiton trofeun

Raporti i AMF për 3-mujorin e parë/ SIGAL UNIQA, kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve

Klinika Lëvizëse “SIGAL UNIQA Vital Truck”, dy ditë vizita dhe ekzaminime falas në Divjakë

Dita Botërore e Shëndetit/ Risitë dhe dëmet e paguara, arsyet pse SIGAL UNIQA mbetet më e besuara në treg

“SIGAL UNIQA FOND PENSIONI”

Fondi më i madh i pensioneve private për asete në Shqipëri, feston 18-vjetorin e themelimit

## KOSOVË

Raporti i BQK/ SIGAL UNIQA Group Austria, lidere e sigurimeve edhe në Kosovë

40 TROFE/ SIGAL PRISHTINA, SHTËPIA E KAMPIONËVE

Edicioni i tretë i Panairit Ndërkombëtar të Turizmit “Kosova 2024”

## Maqedoni e Veriut

Në mbështetje të garës së grave “Avicena 2024”

Procesi i edukimit në “UNIQA” nuk përfundon kurrë

## Uniqa Insurance Group

UNIQA publikon raportin e kapitalit, të aftësisë paguese dhe qëndrueshmërisë për vitin 2023

UNIQA: Më shumë shërbime për një shëndet më të mirë

## jetojmë më mirë së bashku

SIGAL UNIQA Group Austria është sot një kompani me standarte tërësisht europiane, e cila i shërben me përkushtim klientëve, qytetarëve, komunitetit, u shërben atyre me të cilët ne shkëmbehem në rrugë, atyre që sapo dalim nga shtëpia dhe u themi mirëmëngjes, atyre me të cilët ndajmë jetën në qytet, atyre me të cilët ndajmë vlerat dhe jetën tonë të përditshme. Çdo ditë SIGAL UNIQA punon, rritet, ecën përpara, zgjeron partnerët, stafi n me qëllimin e vetëm: ofrimin e një shërbimi sa më profesional ndaj klientëve që jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat ia besojnë pikërisht kësaj kompanie. Sepse çdo klient i SIGAL UNIQA, i vogël apo i madh, është pjesë e një familjeje të madhe që sot numëron mbi 1 milion anëtarë.

MJEKËT MË TË MIRË NË BOTË NË DISPOZICION  
TË ÇDO INDIVIDIT TË SIGURUAR ME PAKETËN

# “JETË PLUS”

DHE TRE OPINIONE  
MJEKËSORE  
PËR DIAGNOZËN

Kjo paketë sigurimi SIGAL UNIQA  
ju mbulon shpenzimet deri në  
**1,000,000 Euro** për këto sëmundje:

**160€**  
DERI  
NË **300€**  
NË VIT/  
PERSON



Apliko online  
duke skanuar barkodin

# “SIGAL UNIQA” zhvillon Konferencën Rajonale/ Ponari: Më të mirët! Shkojmë tek klienti me çdo produkt sigurimi



Me pjesëmarrjen e stafëve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, Grupi më i madh i sigurimeve “SIGAL UNIQA” zhvilloi gjatë fundjavës Analizën Rajonale për 3-mujorin e parë të vitit.

Takimi u hap nga themeluesi dhe CEO i grupit, z.Avni Ponari, i cili gjatë fjalës së tij rënditi disa prej arsyeve pse “SIGAL UNIQA” mbetet kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

“Jemi më të mirët në treg pasi jemi i vetmi grup që kemi në përbërjen tonë një kompani risigurimi dhe një fond pensioni privat.

Si asnjë tjetër, ofrojmë për klientët tanë çdo produkt sigurimi që ofron çdo kompani në Europë dhe në botë. Ndaj jemi të vlerësuar kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht”, tha ndër të tjera Ponari.

Takimi rajonal vijoi më pas me Kampionatin e Futbollit me mes ekipeve nga të trija shtetet

ku fituese u shpall ai i Kosovës.


## **SIGAL UNIQA Group Austria, 25 vite lidere në treg**

SIGAL u themelua në shkurt 1999 dhe prej vitit 2007 është pjesë e “UNIQA Insurance Group”, një prej grupeve më të mëdhenj të sigurimeve në Austri dhe Evropë.

Grupi “SIGAL UNIQA” operon suksesshëm në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes 8 kompanive: 3 Sigurimi Jo-Jete, 3 Sigurimi Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni duke kryesuar tregun në këto shtete e duke qenë mes Top 50 kompanive më të mëdha në Europën Juglindore.

Grupi numëron mbi 1200 zyra dhe 2400 punonjës dhe agentë që u shërbejnë çdo ditë mbi 1.2 milionë klientëve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

SIGAL UNIQA Group Austria, jetojmë më mirë së bashku



# Mini-kampionati “SIGAL UNIQA” Kosova fiton trofeun



Konferenca Rajonale e Grupit të sigurimeve “SIGAL UNIQA” shërbeu edhe për të bërë bashkë punonjësit e kompanisë nga të trija shtetet, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut.

Nën moton “punojmë më mirë së bashku”, 6 ekipe nga të trija shtetet, SIGAL UNIQA Shqipëri, SIGAL UNIQA Kosovë dhe UNIQA – Maqedoni e Veriut garuan me njëri-tjetrin për fitimin e Kampionatit që mori emrin e kompanisë.

Pas sfidave shumë të luftuara, ekipi i SIGAL UNIQA Kosovë u shpall fitues teksa mposhti në finale përmes penalltive ekipin e UNIQA – Maqedoni e Veriut.

Qëllimi i këtij kampionati, me pjesëmarrjen e ekipeve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, nuk synonte thjesht shpalljen e një fituesi por dhënien e mesazhit se sporti përveç se një element i rëndësishëm për shëndetin tonë, na bën të jemi më të bashkuar me kolegët tanë, na mëson punën në grup dhe na bën më socialë.


SIGAL UNIQA Group Austria, jetojmë më mirë së bashku!




## SIGAL UNIQA LIDERE E TREGUT TË SIGURIMEVE



Ndarja e Tregut të Sigurimeve të Jo-Jetës  
Mars 2024



Ndarja e Tregut të Sigurimet e Jetës  
Mars 2024



Burimi: Raporti Statistikor i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

# Raporti i AMF për 3-mujorin e parë/ SIGAL UNIQA, kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve

Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) publikoi paraditen e sotme raportin mbi ecurinë e tregut të sigurimeve në Shqipëri për 3-mujorin e parë të këtij viti.

Sipas raportit në fjalë, tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90.99% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.93% dhe risigurimi me 0.076%.

Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas kompanive, SIGAL UNIQA Group Austria vijon të jetë kompania e sigurimeve më e madhe dhe më e besuar, si në sigurimet e Jo-Jetës ashtu edhe në ato të Jetës.

Mes 12 kompanive të sigurimit që operojnë në Shqipëri, Grupi SIGAL UNIQA zë 26% të tregut.

Sa i përket primeve të shkruara në sigurimet e Jo-Jetës, aty ku operojnë 8 kompani, SIGAL UNIQA mbetet më e besuara teksa zë rreth 25% të tregut.

Edhe në dëmet e paguara, SIGAL UNIQA vijon të jetë në krye të tregut teksa për periudhën janar-mars 2024 ka paguar rreth 25% të totalit.

Në Sigurimet e Jetës, SIGAL LIFE UNIQA Group Austria vijon të jetë dominuese në treg.

Nga 4 kompani që operojnë në këtë treg, SIGAL LIFE UNIQA zë 41% të tij.

Edhe në dëmet e paguara tek klientët, SIGAL LIFE UNIQA nuk ka rivalë.

Për 3-mujorin e parë të vitit kompania ka paguar

rreth 56% të totalit që ka paguar i gjithë tregu i sigurimeve të Jetës në Shqipëri.

SIGAL u themelua në shkurt 1999 dhe prej vitit 2007 është pjesë e “UNIQA Insurance Group”, një prej grupeve më të mëdhenj të sigurimeve në Austri dhe Evropë.

SIGAL UNIQA operon suksesshëm në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes 8 kompanive të saj: 3 Sigurimi Jo-Jete, 3 Sigurimi Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni duke kryesuar tregun në këto shtete e duke qenë edhe mes Top 50 kompanive më të mëdha në Europën Juglindore.

Falë strategjisë së ndjekur, modelit të biznesit, menaxhimit financiar, stafit profesional dhe korrektesisë kontraktuale kompania është sot lidere e tregut shqiptar dhe rajonal të sigurimeve.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është e vetmja kompani që ofron të gjitha klasat e sigurimeve, duke numëruar mbi 2400 punonjës e agjentë në mbi 1200 zyra në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ku operohet me standarte tërësisht evropiane.

Mbi 500 milionë euro dëme të paguara në 25 vite, janë dëshmia më e madhe e fuqisë, përgjegjshmërisë dhe korrektesisë që ka shoqëruar këtë kompani prej çerekshekulli.

Ndaj edhe sot, nën moton “Jetojmë më mirë së bashku”, mbi rreth 1.2 milionë klientë vazhdojnë t’i besojnë kësaj kompanie jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat.

# Klinika Lëvizëse “SIGAL UNIQA Vital Truck”, dy ditë vizita dhe ekzaminime falas në Divjakë

Klinika Lëvizëse “SIGAL UNIQA Vital Truck” ka mbyllur një tjetër rrugëtim të suksesshëm shërbimi mjekësor FALAS, këtë here në qytetin e Divjakës.

I vendosur në qendër të qytetit në datat 19 dhe 20 prill, kamioni i përshtatur si një klinikë lëvizëse ka mirëpritur qindra qytetarë duke ofruar shërbime si:

- ✓ Vizitë dhe konsultë me mjek të përgjithshëm,
- ✓ Vizitë dhe konsultë me mjek specialist,
- ✓ Vlerësim dhe ekzaminim i gjendjes së përgjithshme: BMI-peshë-gjatësi,
- ✓ Matje e nivelit të sheqerit në gjak,
- ✓ Matje e oksigjenit në gjak,
- ✓ Vizitë e syve dhe veshit për probleme akute/infeksione, etj.,
- ✓ Elektrokardiograma e zembrës, matje e tensionit dhe e frekuencës së zembrës,
- ✓ Echo abdominale,
- ✓ Matje e kapacitetit vital të mushkërive, spirometry, etj.

Klinika Lëvizëse SIGAL UNIQA Vital Truck ka synimin që të zgjerohet në qytete të tjera, duke vazhduar misionin e saj për të sjellë kujdes shëndetësor cilësor në komunitete të ndryshme.

SIGAL UNIQA Group Austria, Jetojmë më mirë së bashku!





# Sigurimi Privat i Shëndetit

Sigurimi privat i shëndetit është mundësi për mbulim të kostove financiare në rast sëmundje të papritur.



**PARANDALIM**



**TRAJTIM MJEKËSOR**



**REHABILITIM**



**ASISTENCË**



**TRANSPORT MJEKËSOR**

Shëndeti  
vjen i pari



Apliko online  
duke skanuar barkodin





# jetojmë më mirë së bashku

Produkte sigurimi që  
të përmirësojnë jetën

# Ju mund të siguroheni ONLINE!

Si shumë industri të tjera, edhe ajo e sigurimeve po shkon gjithmonë e më shumë drejt dixhitalizimit duke bërë që një pjesë e mirë e kompanive të ofrojnë thujse çdo produkt edhe online.

Blerja online e policës së sigurimit është mënyra që po rritet muaj pas muaji dhe që ofron disa përfitime, përveç kohës së shpejtë.

Ja cilat janë përfitimet kryesore të blerjes Online të sigurimit:



## 1- Komfort

Mund ta bleni nga shtëpia, zyra, apo kudo që të ndodheni nëpërmjet telefonit tuaj, pa qenë nevoja të shpenzoni kohë të tepërt për të kërkuar një zyrë, apo një agjent që t'ju shërbejë.

## 2 – Kursim kohe

Duke porositur ose blerë online policën e sigurimit që ju nevojitet ju kurseni edhe kohë. Kjo pasi nuk duhet të dilni nga shtëpia apo puna, të përdorni automjetin apo transportin publik për të shkuar pranë kompanisë së sigurimit.

## 3- Informim

Interneti ofron informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me çdo policë siguri për të cilën interesoheni. Me anë të tij, mund të bëni krahasimin e disa policave të sigurimit online dhe mund të merrni një vendim të mirëinformuar në lidhje me policën që ju përshtatet më shumë.

## 4- Prime më të lira

Një nga pikat më të forta të shitjes së sigurimeve në internet kanë qenë përfitimet e kostos që ka sjellë për blerësit.

Si klient, kur blini policën e sigurimit online, ndihmoni siguresin të kursejë kostot operative dhe komisionet e ndërmjetësve. Dhe për shkak se e gjithë procedura ndodh online dhe është pa shkresa, kostot ulen më tej.

## 5- Automatizim

Edhe nëse nuk jeni shumë të informuar në lidhje me mënyrën e pagesës online, platformat e policave të sigurimit mundësojnë pagesë të shpejtë të primit të sigurimit nëpërmjet mënyrave të sigurt dhe të mbrojtura të kryerjes së transaksioneve.

## 6- Asistencë e shpejtë

Edhe nëse keni vështirësi fillestare në përdorimin e platformës së blerjeve të sigurimit online, kompanitë e sigurimit ofrojnë asistencën online me anë të së cilës operatori mund t'ju udhëzojë hap pas hapi deri në mbyllje të procedurës.

## 7 – Mbrojtje ndaj mjedisit

Nga viti 2010 deri në vitin 2060, konsumi global i letrës pritet të dyfishohet. E njëjta gjë do të jetë edhe sasia e mbeturinave të letrës.

Një rritje e prodhimit të letrës rrit gjithashtu shpyllëzimin e pyjeve në mbarë botën që tashmë janë në një gjendje kritike dhe vazhdimisht përkeqësohen.

Me Sigurimin Online ne përveç se kursejmë kohë dhe para, ndikojmë pozitivisht edhe në mjedis.

BLI KËTU ONLINE SIGURACIONIN QË JU NEVOJITET

# Dita Botërore e Shëndetit/ Risitë dhe dëmet e paguara, arsyet pse SIGAL UNIQA mbetet më e besuara në treg

7 Prilli është Dita Botërore e Shëndetit, e cila përkon me themelimin e Organizatës Botërore të Shëndetit më 1948.

Ajo kremtohet çdo vit duke përcjellë mesazhe mbi rëndësinë e shëndetit tek njeriu.

Ndryshimet klimatike, stili i jetesës, pandemia COVID-19 kanë krijuar një kërcënim ekzistencial për jetën në këtë planet dhe kanë ndryshuar në mënyrë dramatike shëndetin dhe mirëqenien tonë, si dhe konceptin tonë mbi to.



Sot, në Ditën Botërore të Shëndetit, SIGAL UNIQA Group Austria është krenare të thotë se, nëse ka një arsye shumë të fortë pse edhe pas 24 vitesh nga themelimi kompania mbetet lidere e tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe Kosovë, pa dyshim që është novacioni dhe risitë që kjo kompani sjell vazhdimisht për klientët e saj, kryesisht në sigurimet e shëndetit.

Më i fundit është “Sigurimi anti-Tumor”, siguracioni dedikuar plotësisht një siguracion dedikuar plotësisht kancerit malinj dhe tumorit beninj në kokë.

Nën moton “merr paratë dhe kujdesu për

shëndetin”, ky produkt unik ofron mbulim financiar të menjëhershëm në rast diagnostifikimi me një prej këtyre dy sëmundjeve.

Shumën e siguruar e zgjedh vetë i siguruari. Duke filluar nga 5 mijë, 50 mijë, 100 mijë euro apo edhe më shumë.

Përfitimet e “Sigurimit anti-Tumor”:

- Nuk plotëson pyetësor shëndetësor
- Kualifikohesh menjëherë nëse nuk je diagnostikuar më parë me tumor malinj dhe as nuk po trajtohesh aktualisht
- Zona e mbulimit është e pa limituar (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut...)
- Nuk ka limit moshe
- Shuma monetare që zgjedh i siguruari akordohet menjëherë pas diagnostifikimit.
- Opinion i dytë mjekësor për çdo diagnozë të gjetur (jo vetëm tumoret malinje) dhe për të marrë mendim të specializuar për mënyrën më të avancuar të trajtimit;
- Mund të porositet edhe Online në [sigal.com.al](http://sigal.com.al)

Një tjetër produkt unik i SIGAL UNIQA është edhe “Jetë Plus”, i cili mbulon gjithçka nevojitet në rast sëmundjesh serioze si:

- Tumore
- Bypass të arterieve koronare
- Ndërrimin dhe riparimin e valvulave të zemrës
- Transplant i organeve dhe indeve të dhuruesve të gjallë (rastet e leuçemisë)
- Neurokirurgjinë (ndërhyrje në kokë dhe në shtyllën kurrizore)

Nëse keni “Jetë Plus”, për gjithçka më pas mendon SIGAL UNIQA. Duke nisur nga:

- Konfirmimi i diagnozës nga mjekë të huaj
- Përzgjedhje të spitalit më të mirë për diagnozën e identifikuar
- Ndërhyrja kirurgjikale dhe trajtimi jashtë vendit
- Çdo procedurë që ju duhet për të qenë të sigurt se po merrni shërbimin mjekësor më të mirë në botë, pa u shqetësuar për organizimin apo pagesat.
- Mbulim të shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit nga fillimi deri në fund të trajtimit për pacientin dhe të afërmin që e shoqëron.
- Mbulim të shpenzimeve deri në 1 Milion Euro.

# “SIGAL UNIQA FOND PENSIONI”

## Fondi më i madh i pensioneve private për asete në Shqipëri, feston 18-vjetorin e themelimit

“Viti 2024 shënon një rast gëzimi për ne, sepse këtë vit festojmë 18-vjetorin e SIGAL UNIQA FOND PENSIONI. 18 vjet përkushtim, zhvillim, dhe siguri financiare për popullin shqiptar. Ky rast nuk është vetëm një arsye feste për ne; Ky rast është një dëshmi e angazhimit tonë të palëkundur për të ndihmuar individët të sigurojnë të ardhmen e tyre financiare.

SIGAL UNIQA FOND PENSIONI aktualisht mbart një vlerë totale të aseteve prej 2,872,482,147.69 Lekë. Ne kemi pasur privilegjin të bashkëpunojmë me 134 biznese të cilët na kanë besuar mirëqenien e tyre financiare. Gjithashtu, jemi krenarë që kemi 12,195 klientë që kanë bërë zgjedhjen e mençur për të investuar në të ardhmen e tyre me ne”.

**Elvis Ponari – CEO “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”.**



Kurse **100** €/muaj për fëmijën tënd, dhe kur ai/ajo të jetë gati për fakultet, do të ketë në llogari **31,500**€

Nëse tërhiqet nga ky fond dhe shpenzohet **10,000**€ për fakultetin, fëmijës suaj do t'i mbeten në llogari **21,500**€

Nëse këto para (pa shtuar asgjë) fëmija juaj nuk i tërheq deri në mbushjen e moshës për pension, ai/ajo do të ketë në llogari **87,000**€

dhe do të marrë një pension mujor prej

**650** €/muaj


### KUSHTET:

- Investimi fillestar duhet të jetë kryer për një periudhë 18-vjeçare.
- Periudha e investimit pas 18 viteve duhet të jetë 35 vjet.



# Raporti i BQK/ SIGAL UNIQA Group Austria, lidere e sigurimeve edhe në Kosovë

Banka Qëndrore e Kosovës ka publikuar ditën e sotme raportin mbi ecurinë e tregut të sigurimeve për 3-mujorin e parë të vitit. Sipas raportit, mes 10 kompanive që operojnë në Kosovë, SIGAL UNIQA Group Austria vijon të jetë kompania më e madhe dhe më e besuar në sigurimet e Jo-Jetës. Me 17% të totalit të tregut, ku operojnë 10 kompani sigurimi, SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë ka shënuar rritje domethënëse krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Në janar-mars 2023, SIGAL UNIQA numëronte 4,781,460 Euro prime, ndërsa në 3-mujorin e parë 2024 numëron rreth 6.5 milionë euro prime të shkruara. Shifra këto që tregojnë besimin në rritje ndaj kësaj kompanie.



Sa i përket dëmshpërblimeve, gjatë periudhës janar-mars 2024 SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë ka paguar tek klientët e saj mbi 2,1 milionë Euro.

SIGAL UNIQA Group Austria – Kosovë mbetet lidere e tregut edhe në sigurimet vullnetare duke lënë shumë pas kompanitë e tjera të sigurimeve.

Një tjetër klasë e sigurimit ku SIGAL UNIQA nuk njih rivalë në Kosovë është edhe Sigurimi i Pronës, si në prime ashtu edhe në dëmet e paguara.

Raporti i plotë i BQK

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA – Kosova do të themelohej në tetorin e vitit 2003 në kuadër të ndërkombëtarizimit të aktivitetit të SIGAL sh.a, përmes blerjes së një kompanie ekzistuese të sigurimeve.

SIGAL UNIQA Group Austria – Kosova u licensua nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si kompani e sigurimit të përgjithshëm të jo-jetës, ndërsa në vitin 2011 do të themelohej edhe SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA, si kompani e sigurimit të jetës.

Sot pas më shumë se 20 vjetësh, SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë është kompania lider e

sigurimeve, si për pozicionin që ze në treg ashtu edhe për dëmet e paguara tek klientët e saj.

Sot Grupi “SIGAL UNIQA” numëron mbi 1.2 milionë klientë dhe është shndërruar në një grup rajonal sigurimesh.

Me 8 kompani sigurimi Jetë dhe Jo-Jetë, Risigurime dhe Fond Pensionesh, “SIGAL UNIQA” është kompania e vetme që ofron të gjitha klasat e sigurimit dhe është çdo ditë pranë klientëve të saj me rreth 2,200 punonjës dhe agjentë, dhe mbi 1,200 zyra në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut por pa harruar edhe platformën “SIGAL ONLINE”

**Primet e Shkruara Bruto nga Kompanitë e Sigurimit të Jo-Jetës**  
*Gross Written Premiums by Non Life Insurance Companies*

Kompania e sigurimit <i>Insurance company</i>	Vlera (në Euro) <i>Value (in Euro)</i>		Ndryshimi (në %) <i>Change (in %)</i>	Pjesa ndaj Totalit (në %) <i>Share in total value (in %)</i>	
	2023	2024	24/23-1	2023	2024
<b>Primi i Shkruar Bruto / Gross Written Premiums</b>					
Dukagjini	2,187,782	2,620,972	19.80	6.76	6.80
Eurosig	4,094,525	4,799,501	17.22	12.64	12.46
Elasig	3,251,977	4,193,749	28.96	10.04	10.88
Ilynia	4,095,994	4,657,221	13.70	12.65	12.09
Instig	-	-	#DIV/0!	0.00	0.00
Kosova e Re	-	-	#DIV/0!	0.00	0.00
Pnsig	2,763,343	3,009,464	8.91	8.53	7.81
Scardian	4,230,321	4,869,760	15.12	13.06	12.64
Sigal UGA	4,781,460	6,459,364	35.09	14.76	16.76
SigKos	1,639,765	1,036,918	(36.76)	5.06	2.69
Sigma VIG	3,091,551	3,653,143	18.17	9.55	9.48
Siguria	2,250,873	3,231,671	43.57	6.95	8.39
<b>TOTAL</b>	<b>32,387,592</b>	<b>38,531,764</b>	<b>18.97</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

# 40 TROFE/ SIGAL PRISHTINA, SHTËPIA E KAMPIONËVE

I lumtur dhe shumë krenar që SIGAL Prishtina arriti edhe një herë të shkruajë historinë e basketbollit, jo vetëm në Kosovë por edhe në kontinent.

Suksesi në Qipro, ndaj Ael Limassol, i dha klubit prishtinas titullin e tretë të Ligës Ballkanike, një sukses i rëndësishëm për të cilin duhen falenderuar lojtarët dhe drejtuesit. SIGAL UNIQA Group Austria dhe SIGAL Prishtina kanë 20 mbi vite që ecin së bashku dhe e them me shumë krenari që klubi ka ditur të përfaqësojë denjësisht kompaninë teksa sot numëron plot 40 trofe, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

SIGAL UNIQA ka qenë gjithmonë një ogur i mirë për sportin dhe sportistët.

Luiza Gega e ka nisur aktivitetin e saj me logon e SIGAL UNIQA-s. Edhe Izmir Ismajlaj e ka nisur aktivitetin e tij po me logon e SIGAL UNIQA-s.

Me sponsor gjeneral SIGAL UNIQA-n, Valbona ishte ekip që e udhëhoqi për 5 vite rresht basketbollin në Shqipëri. Ndërsa sot vijojmë të jemi sponsorë të kombëtareve të futbollit dhe të basketbollit në Shqipëri dhe Kosovë, të klubit të Vllaznisë dhe mbështesim një seri aktivitetesh sportive siç është edhe LIGA UNIKE në basketboll.

Sepse, SIGAL UNIQA është mësuar të bashkëpunoj vetëm me kampionë!

Ne besojmë fort se Sporti është mjeti më efikas i edukimit, i argëtimit, i parandalimit të sëmundjeve, dhe forcimit të marrëdhënieve sociale.

Prandaj, duke uruar edhe një herë SIGAL Prishtinën për suksesin e arritur, apeloj për më shumë vëmendje ndaj sportit, kryesisht në Shqipëri, si ambasadori dhe reklama më e mirë e një kombi.

HOME OF CHAMPIONS

40

Trofe

15 KUPA | 14 TITUJ | 8 SUPERKUPA | 3 TITUJ BALLKANIKË

Së bashku me ju

SIGAL UNIQA

UNIQA GROUP AUSTRIA

# Edicioni i tretë i Panairit Ndërkombëtar të Turizmit “Kosova 2024”

Është mbajtur edicioni i tretë i Panairit Ndërkombëtar të Turizmit Kosova 2024, i organizuar nga Unioni i Turizmit të Kosovës, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës.

Si një nga ngjarjet më të rëndësishme në vendin tonë, Sigal UNIQA Group Austria mbështeti fuqishëm zhvillimin e panairit, përmes sponsorizimit të një eventi të tillë, i cili shënoi një kapitull të ri në fushën e turizmit.

Gjithashtu, SIGAL UNIQA informoi vizitorët dhe pjesëmarrësit e interesuar rreth Sigurimit të Shëndetit në Udhëtim, si pjesë e domosdoshme e çdo udhëtimi. SIGAL UNIQA Group Austria ishte në mesin e 300 kompanive të ndryshme pjesëmarrëse, nga 15 shtete të ndryshme të botës.





Maqedoni e Veriut

## Në mbështetje të garës së grave “Avicena 2024”



Në frymën e sportit, pjesë e ekipit të femrave të UNIQA AD Skopje, nën sloganin "Jetojmë më mirë së bashku" u bashkuan dhe mbështetën garën e grave #Avicena 2024.

Edhe një herë, ne theksojmë rëndësinë e një kompanie në transmetimin e zakoneve pozitive në shoqëri, si dhe rëndësinë e inkurajimit dhe motivimit të ekipit në zakone të shëndetshme të jetesës.

Ne vazhdojmë të vrapojmë dhe jetojmë më mirë së bashku!

## Procesi i edukimit në “UNIQA” nuk përfundon kurrë

Puna ekipore, profesionalizmi, mësimi i vazhdueshëm dhe transferimi i njohurive janë bazat e mënyrës sonë të punës.

Procesi i edukimit nuk përfundon kurrë. Sot në Shkup dhe Veles ne ua transferuam njohuritë e sigurimit të jetës anëtarëve ekzistues dhe të rinj të ekipit tonë.

Zbuloni potencialin në veten tuaj dhe bëhuni pjesë e ekipit tonë inovativ të shitjeve, ku kompania ju ofron mundësinë të tejkaloni qëllimet tuaja dhe të provoni potencialin tuaj.

Nëse dëshironi të jeni pjesë e ekipit të “UNIQA” në Maqedoninë e Veriut, regjistrohuni në: [kariera@uniqa.mk](mailto:kariera@uniqa.mk)



# UNIQA publikon raportin e kapitalit, të aftësisë paguese dhe qëndrueshmërisë për vitin 2023



“Viti financiar 2023 ishte një tjetër vit i suksesshëm për “UNIQA Insurance Group.”

Si grup, ne ishim në gjendje të rriteshim ndjeshëm në primet e shkruara me rreth 10% dhe të rrisnim më tej fitimet tona në 426 milionë euro, pavarësisht nga stuhitë ekstreme që prekën veçanërisht Austrinë vitin e shkuar”.

Kështu shprehet Kurt Svoboda, CFO/CRO i “UNIQA Insurance Group”.

Sipas tij, viti 2023 u karakterizua nga zhvillimet mjaft pozitive të kompanive në Evropën Qëndrore dhe Lindore, të cilat dhanë një kontribut të konsiderueshëm prej rreth 50% në rritjen e rentabilitetit.

“Për vitin financiar 2024, ne po përqendrohemi në përmirësimin e mëtejshëm të biznesit tonë kryesor të sigurimeve në dy tregjet tona vendase, Austri dhe EQL,” thotë Svoboda, duke dhënë një perspektivë.

“Bazuar në një raport të aftësisë paguese prej të paktën 170%, ne përpiqemi t'i lejojmë aksionarët tanë të marrin pjesë në suksesin e kompanisë sonë në mënyrë progresive, pra me pagesa të dividendëve në rritje çdo vit. Raporti i pagesave do të mbetet i pandryshuar deri në 60%”

Me kalimin në standardet e reja të kontabilitetit SNRF 17 dhe SNRF 9 nga 1 janari 2023, UNIQA ka rregulluar gjithashtu llogaritjen e objektivave të fitimeve për vitin 2024 në përputhje me rrethanat.

Një rritje e primit prej 4%, një raport i kostos totale prej 32.5%, një raport i kombinuar në sigurimin e pronës dhe viktimave prej 92%, një kthim mbi kapitalin prej 14%, një raport aftësie paguese 170% dhe kënaqësia e klientit që është rritur me 4,5 yje, dividenti duhet të jetë së paku 0.57 euro.

Primet e shkruara u rritën me 10% në 2023, ndërsa fitimet para taksave u rritën në 426 milionë euro.

“Raporti i kombinuar është përmirësuar ndjeshëm në 89.4%, ku një rol të rëndësishëm në këtë ka luajtur edhe zhvillimi shumë i mirë i nënshkrimit të biznesit ndërkombëtar.

Në vitin 2023, vëmendje e veçantë i është kushtuar ekosistemit shëndetësor.

“Gjatë viteve të ardhshme, 245 milionë euro do të investohen në spitalet tona private, në rrjetin tonë të mjekëve, në telemjekësi, por edhe në kujdesin shëndetësor në punë dhe kujdesin 24-orësh në shtëpi”, shpjegon Svoboda.

Raporti i kapitalit rritet në 255%

UNIQA ka një raport të fortë dhe të qëndrueshëm të kapitalit rregullator sipas Solvency II prej 255%, në rritje krahasuar me një vit më parë (2022: 246%).

### **Raporti i grupit për aftësinë paguese dhe pozicionin financiar do të publikohet më 17 maj 2024.**

Raporti rregullator i kapitalit, për të cilin UNIQA nuk përdor asnjë dispozitë kalimtare, rezulton nga raporti i kapitalit të vet prej 5,941 milionë euro (2022: 5,607 milionë euro) dhe kërkesa e kapitalit të vet prej 2,328 milionë euro (2022: 2,284 milionë euro).

Pjesa e kapitalit të sigurt (kapitali bazë) aktualisht përbën 86% të fondeve të vetë UNIQA.

<https://www.uniqagroup.com/grp/sustainability/ueberblick.de.html>

### **Raporti i qëndrueshmërisë**

Raporti i Qëndrueshmërisë 2023 përshkruan ndikimet ekonomike, ekologjike dhe sociale të aktiviteteve të korporatës në mbarë grupin gjatë vitit financiar 2023.

Një ndër pikat kryesore kanë qenë edhe çështjet mjedisore.

UNIQA është e përkushtuar ndaj objektivit 1.5 gradë të Marrëveshjes së Parisit për Klimën dhe është anëtare e shoqatave dhe nismave të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Organizata e njohur ka konfirmuar objektivat e përkohshme për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë.

### **Qëllime të qarta për reduktimin e emetimeve të lidhura me sigurimet**

Si një anëtar i Aleancës Austriake të Financave të Gjellbërta (GFA), është veçanërisht e rëndësishme për UNIQA-n që të vendosë objektiva të qarta për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë të lidhura me sigurimet, në

ënyrë që t'i reduktojmë ato në zero neto.

Duke përdorur metodologjinë PCAF (Partnership for Carbon Accounting Financials) për matjen e emetimeve të lidhura me sigurimet, UNIQA ishte në gjendje të kryente llogaritjen në hapin e parë për portofolin tonë të korporatës austriake.

### **Prezantimi i sistemit të menaxhimit mjedisor EMAS**

Shtatë auditime mjedisore të kryera nga EMAS dhe futja e sistemit të menaxhimit mjedisor EMAS në vendet e shitjeve në Austri do ta bëjnë UNIQA një kompani të certifikuar deri në fund të vitit 2024.

Veprojmë me përgjegjësi së bashku

Duke iu bashkuar Aleancës së Pronarëve të Aseteve Neto Zero të Kombeve të Bashkuara (NZAOA), UNIQA është zotuar të konvertojë portofolin e saj të investimeve në emetime neto të gazrave serrë deri në vitin 2050.

Në vitin 2023, Grupi UNIQA raportoi në NZAOA për herë të parë, duke kontribuar në raportin vjetor të progresit.

### **Perspektiva e kompanisë**

Për vitin financiar 2024, i fundit i programit tonë strategjik “UNIQA 3.0 – Mbajllja e së ardhmes”, UNIQA po përqendrohet në përmirësimin e mëtejshëm të biznesit tonë kryesor të sigurimeve në dy tregjet tona, Austri dhe EQL.

### **Pritjet një rritje të fortë në sigurimet e pronës dhe shëndetit.**

Megjithatë, në vitin financiar 2024 UNIQA vazhdon të presë shpenzime të larta për shërbimet në sigurimet e pronës dhe shëndetësore si dhe për shkak të inflacionit, në kostot e përgjithshme.

Prandaj është thelbësore të ruhet disiplina strikte e kostos dhe të bëhen vazhdimisht optimizime në menaxhimin e saj.

Këto parashikime janë subjekt i ndikimeve të mundshme negative në rezultatet tona të konsoliduara, të cilat mund të lindin nga trazirat gjeopolitike dhe pasiguritë e shoqëruara për tregjet globale të kapitalit, nga një mjedis i paqëndrueshëm i normave të interesit, zhvillimi i inflacionit në përgjithësi dhe, mbi të gjitha, nga rritja pretendon pagesa si rezultat i katastrofave natyrore. Në lidhje me këtë, ne presim që përfitimi ynë i synuar të jetë në nivelin e vitit 2023.

# UNIQA: Më shumë shërbime për një shëndet më të mirë



Si një kompani lider në sigurimet shëndetësore, UNIQA fokusohet në parandalimin e sëmundjeve përmes ushtrimeve fizike duke nxitur aktivitete të ndryshme në përditshmërinë e të gjithë grupmoshave përmes ofertave specifike.

Mungesa e stërvitjes dhe pasiviteti fizik kanë pasoja afatgjata në shëndetin e njeriut duke qenë një nxitës në shtimin e shumë problemeve shëndetësore dhe sëmundjeve. Si për shembull, obeziteti, tensioni, diabeti, sëmundjet kardiovaskulare, kanceri, por edhe sëmundjet psikologjike dhe mendore.

Sipas “MedUni Vienna”, pothuajse 8% e të gjitha vdekjeve në Austri mund t’i atribuohen mungesës së aktivitetit fizik.

“Ushtrimi i rregullt është një pjesë qendrore e parandalimit dhe për këtë arsye çelësi për një shëndet më të mirë. Njohuritë për një mënyrë jetese të shëndetshme duhet të promovohen në të gjitha fushat e shoqërisë dhe sigurisht që sistemi arsimor është veçanërisht i sfiduar, pasi duhet t’i japë kësaj teme më shumë hapësirë, nga kopshti në universitet”, thekson Peter Eichler, anëtar bordi për sigurimin e personelit dhe menaxhimin e aseteve në UNIQA Insurance Group AG me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit, duke vazhduar:

“Sigurisht, ne jemi këtu për të mbështetur klientët tanë nëse kanë nevojë për kujdes mjekësor. Por pretendimi ynë shkon më tej: Ne duam t’i ndihmojmë njerëzit në Austri të gëzojnë një jetë më të shëndetshme, pa sëmundje. Kjo është arsyeja pse ne u ofrojmë klientëve tanë mbështetjen për të integruar në mënyrë të qëndrueshme më shumë ushtrime në jetën e tyre të përditshme.”

Mbështetje unike: 24 vjet UNIQA “VitalCoach”

Me rrjetin “VitalCoach”, UNIQA është një pionier dhe deri më sot është oferta unike në tregun e sigurimeve.

Rreth 100 VitalCoaches, profesionistë të trajnuar shëndetësorë si shkencëtarë sportivë apo trajnerë të certifikuar, mbështesin dhe këshillojnë me shumë përkushtim klientët tanë në të gjithë Austrinë mbi temat e ushtrimeve, të ushqyerit dhe fitnesit mendor.

E re: “Mavie MentalCoaches” për mirëqenien mendore

Për të përmbushur nevojën në rritje për trajtime psikosociale, nga mesi i muaji prill “Mavie MentalCoaches” do të mbështesë gjithashtu klientët UNIQA që të ndihen mirë psikologjikisht dhe të gjejnë zgjidhje për çështje të tilla si stresi.

Në të gjithë Austrinë, më shumë se 30 psikologë të kualifikuar shëndetësorë, këshilltarë ose psikoterapistë janë të disponueshëm në internet ose në terren në 9 qytete përmes filialit UNIQA dhe partnerit Mavie.

Klientët e UNIQA mund të rezervojnë njësitë VitalCoach dhe njësitë e këshillimit psikosocial si pjesë e VitalPlan, ndër të tjera. Ky shërbim shtesë mund të merret përmes Sigurimit Shëndetësor Privat UNIQA.

Me VitalPlan, UNIQA ka ofruar shërbime të ndryshme shëndetësore që prej vitit 2000: me rreth 8,000 seanca trainimi çdo vit, UNIQA mbështet klientët e saj për të qëndruar të shëndetshëm.

# Sigurimi Kasko

Mbrojtja maksimale për makinën tuaj

Çfarë mbulon?

- ✓ Dëmtime aksidentale
- ✓ Thyerja e xhamave
- ✓ Zjarr, Rrufe, Eksplozion
- ✓ Katastrofat natyrore
- ✓ Vjedhja totale
- ✓ Vjedhja e pjeshme
- ✓ Dëmtim në parkim
- ✓ Akte keqdashëse
- ✓ AutoSOS
- ✓ GPS



Llogarite  
Online

Më mirë  
udhëtoni pa  
shqetësime



## 25 VITE HISTORI SUKSESI

SIGAL UNIQA Group Austria është një prej grupeve më të mëdhaja të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

E themeluar në shkurt 1999, SIGAL UNIQA operon suksesshëm në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes 8 kompanive të saj (6 kompani jete dhe jo-jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fondi Pensionesh).  
PJESË E “UNIQA Insurance Group”

Prej marsit 2007, SIGAL UNIQA është pjesë e “UNIQA Insurance Group”, një prej kompanive më të mëdha të sigurimeve në Austri dhe Evropë.

“UNIQA”, kompani e themeluar në vitin e largët 1811 dhe pjesë e tregut të sigurimeve në 17 shtete të ndryshme të kontinentit, numëron mbi 17 milionë klientë ndërsa është vlerësuar nga “Standard & Poor’s” me “A”.

SIGAL UNIQA Group Austria, jetojmë më mirë së bashku